

AKT – MARREVESHJE PER KRIJIMIN E SHOQERISE SE THJESHTE

AUTO KLARED

ANETARET :

1. **Klajd Bulku** i biri i Besnik, mbajtes i dokumentit Karte Identiteti me Nr.Personal I40416096I me date leshimi 16/10/2019,i dtl. 16/04/1984, lindur ne Durres dhe banuese ne Durres .
2. **Redian Denizi** i biri i Edmond, mbajtes i dokumentit Pasaporte me Nr.Personal I20718168D me date leshimi 29/12/2020, i dtl.18/07/1982, lindur ne Durres dhe banuese ne Durres.

NENI 1

Forma , emri, sigla dhe simboli

- 1.1 Forma e kesaj shoqerie eshte “Shoqeri e thjeshte” ne mbeshtetje te neneve 1074 e vijues te Kreut XXII te Kodit Civil per Shoqerine e Thjeshte.
- 1.2 Shoqeria ka emrin, vulen, logon dhe e-mail-in e saj , e cila eshte pjese perberese e shoqerise.
- 1.3 Emri dhe logo e shoqerise duhet te figurojne ne te gjithe shkresat , komunikimet elektronike , reklamat, si dhe ne cdo veprimetari tjetër qe cmohet e nevojshme nga administratori.
- 1.4 Emri i shoqerise eshte “ **AUTO KLARED**” .
- 1.5 Vula e shoqerise eshte ka mbishkrimin “**AUTO KLARED**”dhe ne mes te saj ka logon.
- 1.6 E-mail i shoqerise eshte autoklared@gmail.com
- 1.7 Logo e shoqerise eshte fjala “ **AUTO KLARED**”. Ngjyra e shkrimit te vules se shoqerise eshte e zeze. Vula pasqyrohet konkretisht si me poshte :
- 1.8 Emri dhe vula e shoqerise jane te drejta te cilat mund te perdoren vetem me miratimin e asamblese se kesaj shoqerie.

NENI 2

Shtrirja territoriale

- 2.1 Selia e shoqerise ndodhet ne : Durres, Sukth , Magazine me numer pasurie 190/18, Zona Kadastrale3542, Sukth i Ri, Durres, Shqiperi.
- 2.2 Selia e Shoqerise mund te ndryshohet me vendim te Asamblese.
- 2.3 Shoqeria kryen aktivitetin e saj ne qytetin e Durresit,Sukth.

NENI 3

Kohezigjatja

Shoqeria zhvillon aktivitetin e saj ne nje periudhe pa afat. Si date krijimi e saj do te jete data e regjistrimit ne QKB.

NENI 4

Qellimi i Shoqerise

Veprimtari ekonomike me qellim fitimi.

NENI 5

Fusha e veprimtarise

Tregtim i autoveturave. Shitje –Blerje autovetura , Dhenia me qera e autoveturave.

NENI 6

Burimet financiare

6.1 Anetari Klajd Bulku ve ne dispozicion nga kursimet e tij shumen prej 50.000 leke.

6.2 Anetari Redian Denizi ve ne dispozicion nga kursimet e tij shumen prej 50.000 leke.

6.3 Kapitali fillestar i shoqerise eshte 100.000 leke , i ndare ne 2 (dy) kuota me pjesemarrje 50% per anetarin Klajd Bulku dhe 50 % per anetarin Redian Denizi.

6.4 Fitimet dhe humbjet e kesaj veprimtarie ekonomike do te ndahen midis anetareve ne fund te vitit duke u percaktuar kjo shume me vendim te asamblese. Me vendim te asamblese do te percaktohet kontributi i cdo anetari dhe ne varesi te ketij kontributi do te behet ndarja e fitimit apo humbjes.

NENI 7

Organet drejtuese te shoqerise

Organet drejtuese te shoqerise jane:

- A. Administratori
- B. Asambleja e anetareve

NENI 8

Administratori

8.1 Administratori menaxhon dhe perfaqeson shoqerine dhe kryen te gjitha veprimet ligjore te shoqerise. Administrator mund te jete cdo njeri nga anetaret.

8.2 Anetari qe nuk merr pjese ne administrim ka te drejte qe te marri njoftim per veprimin qe do te kryej anetari tjetër ne cilesine e administratorit.

8.3 Veprimet e kryera nga anetari i shoqerise si administrator kane efekt mbi shoqerine ne raport me te tretet.

8.4 Administratori i shoqerise eshte Klajd Bulku. Qendrimi i tij ne kete detyre eshte pa afat.

8.5 Administratori ne mbledhjen e Asamblese se Shoqerise raporton mbi bilancin vjetor te shoqerise.

NENI 9

Punesimi

Per ushtrimin e veprimtarise se kesaj shoqerie mund te punesohen me kohe te pjesshme apo te plote persona te tjere per mbarevajtjen e aktivitetit.

NENI 10

Asambleja e Anetareve

10.1 Asambleja e anetareve eshte organi me i larte i vendimmarrjes i shoqerise.

10.2 Asambleja e anetareve perbehet nga te gjithë anetaret e shoqerise.

NENI 11

Funksionet e Asamblese se anetareve

11.1 Ka funksion primar vendimmarrjen dhe mbikqyrjen e veprimtarise se shoqerise.

11.2 Shqyrton ceshtjet ekonomike, financiare dhe te administrimit, si dhe miraton aktet me te rendesishme ne lidhje me shpenzimet per vitin ne vazhdim, miratimin e bilancit ne fund te vitit dhe ndarjen e fitimit.

11.3 Asambleja mblidhet te pakten nje here ne vit.

11.4 Anetaret e asamblese jane te gjithë individet te cilet kane statusin e anetarit te kesaj shoqerie.

11.5 Me vendim unanim te Asamblese mund te shtohen anetare te rinj.

11.6 Me vendim te Asamblese mund ti kalohen kuotat nje anetari tjetere.

NENI 12

Mbarimi i Shoqerise

Shoqeria mbaron me marreveshje te anetareve,.

Me mbarimin e shoqerise percaktohen dhe te drejtat e perdorimit te emrit te shoqerise.

Cdo anetar ka te drejte te largohet nga shoqeria ne cdo kohe.

Pas largimit , anetari ka te drejte te ushtroje te njejten veprimtari , por nuk mund te perdore emrin dhe e-mail-in e shoqerise.

NENI 13


Dispozite kalimtare

Per rregjistrimin e shoqerise ne QKB ngarkohet Klajd Bulku.

ANETARET :

1. Klajd Bulku

(Emer, Mbiemer , Firme)

Klajd Bulku 

2. Redian Denizi

(Emer, Mbiemer , Firme)

REDIAN DENIZI 